

VENDIM
Nr. 280, datë 17.4.2026

Për formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit të të dhënave të agjencisë shtetërore të kadastrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit, që duhet të zbatohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

3. Për qëllim dhe zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Raport i aktivitetit të dyshimtë” (RAD), formulari që subjekti raportues, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, raporton tek autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, për çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi, për veprimtarinë nën juridiksionin e saj, sipas aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) “Raport i transaksionit të vlerave” (RTV), formulari që subjekti raportues, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, detyrohet ta plotësojë dhe ta raportojë, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve, regjistrimin e kontratës së tjetërsimit të pronës, me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, sipas aneksit II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës raporton tek autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve, regjistrimin e kontratës së tjetërsimit të pronës, me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, sipas formularit RTV.

5. Agjencia Shtetërore e Kadastrës raporton menjëherë dhe jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë pranë autoritetit përgjegjës, Agjencisë së Inteligjencës Financiare, çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi për veprimtaritë nën juridiksionin e vet, sipas formularit RAD.

6. Raportimet, sipas kërkesave të formularëve RTV dhe RAD, kryhen në rrugë elektronike, sipas formateve të përcaktuara në këtë vendim.

7. Në zbatim të këtij vendimi, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:

a) cakton në drejtorinë e përgjithshme një person që të shërbejë si person kontakti për autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

b) cakton një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në nivel administrimi ose drejtimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në çdo drejtori vendore të saj, ku të gjithë punonjësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës raportojnë çdo fakt, që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash apo financim terrorizmi;

c) organizon procesin e monitorimit dhe siguron kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ç) ngarkon kontrollin e brendshëm për të monitoruar zbatimin e detyrimeve ligjore nga personat përgjegjës të caktuar për raportimin, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe të këtij vendimi;

d) merr masa administrative dhe bashkëpunon me autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për përgatitjen dhe organizimin e trajnimeve periodike të personave përgjegjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe tipologjitë përkatëse, që lidhen me këto fusha.

8. Personi përgjegjës ka këto kompetenca dhe detyra:

a) Analizon çdo të dhënë apo informacion, që është njoftuar si i dyshimtë, apo ka konstatuar nëpërmjet punonjësve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në funksion të dërgimit të RAD-it në Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

b) Merr çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur funksionet, në përputhje me ligjin dhe këtë vendim;

c) Dërgon RAD-in në Agjencinë e Inteligjencës Financiare, nëse informacioni vlerësohet si i dyshimtë;

ç) Ruan konfidencialitetin në aktivitetin e kryer, në përmbushje të ligjit dhe të këtij vendimi;

d) Personi përgjegjës merr masa për zbatimin e masave parandaluese të përcaktuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar;

dh) Përgatit raport me shkrim, të paktën 1 (një) herë në vit, për procesin e monitorimit, në të cilin përfshin edhe numrin e raporteve të aktivitetit të dyshimtë të identifikuar dhe ia dorëzon atë drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

9. Personit përgjegjës dhe çdo punonjësi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të informojnë personin ose çdo person tjetër për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për raportimin e aktivitetit të dyshimtë, si dhe për çdo informacion që kërkohet nga autoriteti përgjegjës apo për hetimet që janë duke u kryer.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës i kthen përgjigje kërkesave të autoritetit përgjegjës, jo më vonë se brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendrike nga marrja e kërkesës për informacion.

11. Kur autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, ka bllokuar ose përgatitet të bllokojë një transaksion për 72 (shtatëdhjetë e dy) orë, sipas dispozitave të ligjit, apo në rastet urgjente kur ka arsye të bazuar për pastrim parash apo financim terrorizmi dhe ka nevojë urgjente për informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, autoriteti përgjegjës i drejtohet zyrtarisht në formë të shkruar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Gjithashtu, kjo kërkesë brenda ditës së punës duhet të përcillet edhe në rrugë digjitale *online*, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës i vë në dispozicion autoritetit përgjegjës informacionin apo dokumentacionin e kërkuar, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga paraqitja e kërkesës, apo nëpërmjet këqyrjes së informacionit në ambientet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nga personat e autorizuar të autoritetit përgjegjës.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe të pikës 6, të nenit 28, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i ofron akses të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave autoritetit përgjegjës, Agjencisë së Inteligjencës Financiare. Kërkesat për shërbime kadastrale (kërkesë për informacion dhe dokumentacion) ofrohen pas paraqitjes së kërkesës në rrugë digjitale *online*, në përputhje me parashikimet e nenit 63, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, duke iu nënshtruar procedurave të parashikuara në vendimin nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.

13. Ky vendim, së bashku me anekset I, II dhe instruksionet përkatëse, janë të vetmet standarde të pranueshme për raportim tek autoriteti përgjegjës.

14. Udhëzimi nr. 1, datë 1.4.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për formën, mënyrat e procedurat e raportimit të të dhënave të subjekteve, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, shfuqizohet.

15. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Aneksi I
RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni kutinë me kombinime:
<input type="checkbox"/> Pastrim parash <input type="checkbox"/> Financim i terrorizmit <input type="checkbox"/> Fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale <input type="checkbox"/> Pamundësi ushtrimi i vigjilencës së duhur <input type="checkbox"/> Pamundësi ushtrimi i vigjilencës së zgjeruar
2. Zgjidhni kutinë me kombinime:
<input type="checkbox"/> Raport i ri <input type="checkbox"/> Raportimet të lidhura <input type="checkbox"/> Përmirëson një raport të mëparshëm <input type="checkbox"/> Transfertë në tentativë
PJESA I. INFORMACION PËR AKTIVITETIN E DYSHIMTË
1. Statusi ligjor i personit a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar c. <input type="checkbox"/> Person juridik d. <input type="checkbox"/> Shoqëri anonime e. <input type="checkbox"/> OJF; f. <input type="checkbox"/> Organizime ligjore g. <input type="checkbox"/> SH.P.K. (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) h. <input type="checkbox"/> Kujdestar i. <input type="checkbox"/> Degë e shoqërisë së huaj; j. <input type="checkbox"/> PEP; k. <input type="checkbox"/> Tjetër 2. a) Emri: _____ b. Atësia ¹ : _____ c. Mbiemri: _____ 3. Datëlindja/data e regjistrimit: _____ 4. Shtetësia: a. <input type="checkbox"/> Shqiptar b. <input type="checkbox"/> I huaj 5. Vendlindja: _____ 6. Vendbanimi i përkohshëm (nëse ka): _____ 7. Gjinia : a. <input type="checkbox"/> Mashkull; b. <input type="checkbox"/> Femër
8. Dokumenti i identifikimit: a) <input type="checkbox"/> Letërnjoftim b) <input type="checkbox"/> Pasaportë 9. Numri i dokumentit: _____ 10. Nr. personal i identifikimit (NID): _____ 11. Autoriteti lëshues: _____
12. Emërtimi i subjektit: _____ 13. NUIS/NIPT: _____ 14. Adresa e themelimit: _____ 15. Adresa e përkohshëm (nëse ka): _____;
PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË info
PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER
1. Data e kryerjes së transaksionit _____ 2. Monedha: Lek <input type="checkbox"/> Euro <input type="checkbox"/> USD <input type="checkbox"/> GBP <input type="checkbox"/> JPY <input type="checkbox"/> CHF <input type="checkbox"/> CAD <input type="checkbox"/> Tjetër <input type="checkbox"/> 3. Shuma e transaksionit: _____
PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

¹Atësia kur deklarohet

Shpjegime/përshkrime të aktivitetit të dyshimtë: *Shënim: Të strukturohet sipas pikave të mëposhtme:*

1. Përshkrimi i profilit të subjektit të RAD-it;
2. Analiza e rastit, duke përfshirë dhe analizë të historikut të transaksioneve;
3. Anomalitë e vërejtura në transaksion, veprime apo veprimtari të dyshimta;
4. Dyshimet për rastin;
5. Lidhje me raste të tjera të raportuara të dyshimta, nëse ka;
6. Nëse kërkohen udhëzime nga AIF-ja;
7. Të dhëna apo informacione të tjera me interes.

PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

PJESA VI. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES:

Emri: _____ Data e raportimit: ____-____-____
Personi përgjegjës: _____
Tel. _____
Firma: _____ E-mail: _____
Aprovuesi: _____ Adresa: _____

INSTRUKSIONE PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT “RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË” (RAD)

HYRJE

“Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) është formulari, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me anë të të cilit subjekti raporton tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjekti për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale dhe financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale.

Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas rastit, nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash, financim të terrorizmit apo fondet rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas rastit, nëse dërgohet tek AIF-ja një raport i ri, një transfertë në tentativë apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I. INFORMACION PËR AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1. Statusi ligjor i personit: Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë, sipas rastit, individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, OJF, organizime ligjore, sh.p.k. (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj, të tjera.

2. Emri, atësia, mbiemri: Për individin shkruhen emri, atësia dhe mbiemri. Atësia plotësohet kur deklarohet.

3. Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv): Nëse personi, në emër të të cilit kryhet transaksioni/et, është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në

raport duhet të shkruhet në formatin 3.4.1978.

4. Shtetësia: Shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. Vendlindja: Shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur.

6. Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka): Plotësohet nëse personi ka një vend ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

7. Gjinia: a) Mashkull; b) Femër: Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas rastit, nëse individi është mashkull apo femër.

8. Dokumenti i identifikimit: a) letërnjoftim; b) pasaportë; c) nr. personal (NID);

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas llojit të dokumentit të përdorur, për të bërë identifikimin e personit.

9. Numri i dokumentit: Këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, si dhe numri personal.

10. Numri personal i identifikimit. Këtu shkruhet numri personal i identifikimit.

11. Autoriteti lëshues: Këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

12. Emërtimi i subjektit: Këtu shkruhet emri i subjektit.

13. NUIS/NIPT: Shkruhet numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatuësëm.

14. Adresa e themelimit: Shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

15. Adresa e përkohshme (nëse ka): Plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhënat për personat e përfshirë në transaksion.

PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. Data e kryerjes së transaksionit: Data e transaksionit shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke, p.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 5.5.2008.

2. Monedha: Vihet një kryq në një prej kutive, sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit, p.sh.: LEK, USD, GBP, EUR etj.

3. Shuma e transaksionit: Shkruhet shuma në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Në këtë pjesë të raportit, subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit dhe të arsyeve për dyshim. Limiti i karaktereve është vendosur për të siguruar përditësimin e informacioneve voluminoze, që hyjnë në databazë, p.sh.: tabela, figurë, materialet për këtë limit mund të përcillen të zipuara te pjesa V, si më poshtë.

PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

Në këtë pjesë të raportit vendosen të zipuara (deri në 10.MB ZIP) dokumentet që shoqërojnë raportin.

PJESA VI. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave apo emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd.mm.vvvv), si dhe numrin e telefonit/adresën e *email*-it, si dhe adresën e personit përgjegjës, me anë të të cilit autoriteti përgjegjës mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

ANEKSI II
RAPORTI I TRANSAKSIONIT TË VLERAVE (RTV)
(Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 milionë lekë)

Zgjidhni kutinë e duhur:	
<input type="checkbox"/> Raportim i ri	<input type="checkbox"/> Përmirëson një raportim të mëparshëm
<input type="checkbox"/> Përfshihen më shumë se një individ/shoqëri	<input type="checkbox"/> Transaksione të lidhura

PJESA I. PALËT E PËRFSHIRA NË TRANSAKSION
SEKSIONI A – PALA SHITËSE/DHURUESE/TJETËR

a) Emri _____	b) Mbiemri _____
c) Emërtimi i subjektit _____	ç) NID/NUS _____
d) Pjesa takuese _____	

SEKSIONI B
PALA BLERËSE/PRANUESE E DHURIMIT/TJETËR

a) Emri _____	b) Mbiemri _____
c) Emërtimi i subjektit _____	ç) NID/NUS _____
d) Pjesa takuese _____	

PJESA II. INFORMACION PËR TRANSAKSIONIN/ET

Nr. rep.: _____	Nr. kol.: _____	Data e transaksionit: ____ . ____ . ____
Data e kalimit të pronësisë: _____		
Lloji i pasurisë (apartament, arë etj.) _____		
Sipërfaqe: _____		
Adresa e pasurisë: _____		
Nr. i pasurisë: _____		
Zona kadastrale: _____		
Shuma: _____	Zgjidhni monedhën:	LEK <input type="checkbox"/> EUR <input type="checkbox"/> USD <input type="checkbox"/> Tjetër _____

PJESA III. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

a) Emri _____	b) Mbiemri _____
c) Emërtimi i institucionit _____	
Adresa: _____	
Personi përgjegjës: _____	
Data e raportimit: ____ . ____ . ____	Tel: _____
Adresë e-mail-i: _____	
(NIPT): _____	

TË PLOTËSOHET NËSE NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË
INDIVID/SHOQËRI
PJESA I. PALËT E PËRFSHIRA NË TRANSAKSION
SEKSIONI A – PALA SHITËSE

a) Emri _____ b) Mbiemri _____
c) Emërtimi i subjektit _____ ç) NID/ NUS _____
d) Pjesa takuese _____

SEKSIONI B – PALA BLERËSE

a) Emri _____ b) Mbiemri _____
c) Emërtimi i subjektit _____ ç) NID/ NUS _____
d) Pjesa takuese _____

PJESA II. INFORMACION PËR TRANSAKSIONIN/ET

Nr. rep.: _____ Nr. kol.: _____ Data e transaksionit: _____. _____. _____
Lloji i transaksionit: _____
Lloji i pasurisë, objekt i kontratës/transaksionit: _____
Shuma: _____ Zgjidhni monedhën: LEK EUR USD Tjetër _____

PJESA III. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

a) Emri _____ b) Mbiemri _____
c) Emërtimi i institucionit _____
Adresa: _____
Personi përgjegjës: _____
Data e raportimit: _____. _____. _____ Tel: _____
Adresë e-mail-i: _____
(NIPT): _____